



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:255550

Datë: 29.01.2025

Numri i dokumentit: 06774373

Rev.nr.554/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Millena Gjeriq dhe Nenad Llaziq, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N. e R.T. B. Sh.j, sh.p.k., me seli në fshatin ..., rr. “...” pn, Sh., Komuna e O., të cilin e përfaqëson me prokurë Gafurr Elshan avokat nga P., kundër të paditurit A. Q., me adresë në rrugën “...”, lagja “S.”, Komuna e O., të cilin e përfaqëson me prokurë Sadije Mjekiqi avokate nga P., për lirimin e pronës së paluajtshme, duke vendosur sipas revizionit të paditurit, të paraqitur përmes të autorizuarës së tij, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2171/2022 datë 07.06.2024, në seancën e kolegjit, të mbajtur më 09.12.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurit i A. Q., rr. “...”, lagja “...”, Komuna e O., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2171/2022 datë 07.06.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2171/2022 datë 07.06.2024, refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 1374/2011, datë 10.01.2022, në të cilin ishte vendosur " I. Konstatohet tërheqja e propozimit të paditëses- propozuesit të sigurimit i dt. 21.06.2011 për caktimin e masës së sigurimit. II. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N. e R.T. B. Sh.j, sh.p.k., me seli në fshatin ..., rr. “...” pn, Sh., Komuna e O.. III. Detyrohet i padituri A. Q. nga O., me adresë në rrugën

“...”, lagja “...”, Komuna e O., që t’ia liroj nga njerëzit dhe sendet dhe t’ia kthej në posedim të paditëses, pronën e paluajtshme, përkatësisht njësitë kadastrale dhe atë:

Ngastrën **P-....**, parcelë tokë bujqësore, vendi i quajtur D., me sipërfaqe prej 4511 m², Komuna Kadastrale dhe Zona Kadastrale O., dhe të njëjtën të ja dozon në disponim dhe shfrytëzim të lirë paditëses, me pikat e matjes siç është e përshkruar në vijim:

- Prej pikës 2-3 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 22.89 m
- Prej pikës 2- 3 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 58.35 m
- Prej pikës 3- 4 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 59.27 m
- Prej pikës 4-5 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 16.77 m
- Prej pikës 8-10 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 89.30 m, dhe
- Prej pikës 10-1 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia ee frontit është: 86.13 m

Ngastrën **P-....**, parcelë tokë bujqësore, vendi i quajtur D., me sipërfaqe prej 8753 m², Komuna Kadastrale dhe Zona Kadastrale O., me pikat e matjes siç janë:

- Prej pikës 4-5 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 56.23 m
- Prej pikës 5-6 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 4.00 m
- Prej pikës 6-7 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 21.82 m
- Prej pikës 7-8 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 55.27 m
- Prej pikës 8-9 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 49.20 m, dhe
- Prej pikës 9-10 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 112.92 m
- Prej pikës 10-4 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 89.30 m;

Ngastrën **P-.....**, parcelë tokë bujqësore, vendi i quajtur D., me sipërfaqe prej 5185 m², Komuna Kadastrale dhe Zona Kadastrale O., me pikat e matjes siç është janë:

- Prej pikës 11-12 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 34.50 m
- Prej pikës 12-13 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 68.53 m
- Prej pikës 13-14 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 26.04 m
- Prej pikës 14-15 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 48.46 m
- Prej pikës 15-20 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 52.56 m, dhe

- Prej pikës 20.11 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia ee frontit është: 69.37 m;

Ngatrën **P-.....**, parcelë tokë bujqësore, vendi i quajtur D., me sipërfaqe prej 1371 m², Komuna Kadastrale dhe Zona Kadastrale O., me pikat e matjes siç janë:

- Prej pikës 15-16 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 2.29 m
- Prej pikës 16.17 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 31.95 m
- Prej pikës 17-18 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 19.07 m
- Prej pikës 18-19 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 32.23 m
- Prej pikës 19-20 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 18.55 m, dhe
- Prej pikës 20-15 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia ee frontit është: 52.56 m.

Ngatrën **P-.....**, parcelë tokë bujqësore, vendi i quajtur D., me sipërfaqe prej 6571 m², Komuna Kadastrale dhe Zona Kadastrale O., e paluejtshmërisë e cila evidentohet sipas Certifikatës mbi të Drejtat e Pronësisë së Paluajtshme, nr. UL-

....., me numër të njësisë, me pikat e matjes siç janë:

- Prej pikës 1-2 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 25.43 m
- Prej pikës 2- 3 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 153.20 m
- Prej pikës 3- 4 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 134.14 m
- Prej pikës 4-5 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 25.16 m
- Prej pikës 5-6 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 33.43 m, dhe
- Prej pikës 6-7 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 50.64 m
- Prej pikës 7-8 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 49.44 m
- Prej pikës 8-9 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 50.04 m
- Prej pikës 9-10 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 49.97 m
- Prej pikës 10-1 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 40.38 m;

Ngatrën **P-.....**, parcelë tokë bujqësore, vendi i quajtur D., me sipërfaqe prej 32597 m², Komuna Kadastrale dhe Zona Kadastrale O., dhe të njëjtën të ja

dorëzon në disponim dhe shfrytëzim të lirë paditëses, me pikat e matjes siç janë:

- Prej pikës 1-2 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 24.42 m
- Prej pikës 2- 3 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 49.83 m
- Prej pikës 3- 4 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 12.38 m
- Prej pikës 4-5 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 48.91 m
- Prej pikës 5-6 kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 3.43 m, dhe
- Prej pikës 6-7 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 90.51 m
- Prej pikës 7-8 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 30.02 m
- Prej pikës 8-9 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 43.09 m
- Prej pikës 9-10 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 14.08 m
- Prej pikës 10-1 Kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është: 43.25 m.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. IV- Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër aktgjyqimit të lartpërmendur të gjykatës së shkallës së dytë, Ac.nr.2171/2022 datë 07.06.2024, i padituri përmes të autorizuarës së tij, avokate Sadije Mjekiqi nga P., me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të ndryshohen të dy aktgjyqimet e sipërpërmendura ashtu që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar ose të prishen të dy këto aktgjyqime dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Të hedhet kërkesëpadia në pjesën që ka të bëjë me lirimin e ngastrave të cilat sipas të paditurit nuk i ka në posedim dhe nuk ka pretendime për to si dhe ta obligoi paditësen që të paditurit t'ia kompensoi shpenzimet e procedurës.

Në përgjigje të revizionit, i autorizuari i paditëses avokat Gafurr Elshani, ka kontestuar në tërësi themelësinë e pretendimeve të revizionit dhe ka propozuar që revizioni i palës së paditur të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), dhe sipas pretendimeve të revizionit shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionin e palës së paditur dhe përgjigjen në revizion të palës paditëse, si dhe shkesat e lëndës dhe gjeti se:

Revizioni i palës së paditur është i pabazuar.

Nga gjendja faktike e vërtetuar në gjykatën e shkallës së parë rezulton se paditëses kundër të paditurit ka ushtruar padi për lirimin e paluajtshëmrisë. Pretendimet si në padi paditëses i bazojnë në

rrethanat se paditësja N. e R. "T. B." Sh. sh.p.k. është shfrytëzues me kohë të caktuar si qirambajtje për 99 vite e pronës së paluajtshme që është objekt i këtij kontesti sipas Certifikatës mbi të drejtat e pronësisë të pronës së paluajtshme nr. UL-..... dhe se paditëses të drejtat e shfrytëzimit me kohë të caktuar në qirambajtje për 99 vite i ka fituat nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit – tani Privatizimit, në bazë të Marrëveshjes dhe Deklaratave të transferit të dt. 28.09.2009, e të cilat tani më i mban në posedim të paligjshëm i padituri A. Q. nga O.. Ndaj i ka propozuar gjykatës që të detyrohet i padituri A. Q. nga O., që paditësja të ja lirojë nga njerëzit dhe sendet pronën e paluajtshme. Gjykata e shkallës së parë pasi ka administruar provat e çështjes ka nxjerr aktgjykimin e atakuar duke vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në gjendjen e fakteve dhe provave të çështjes.

I padituri pretendon se nuk e ka të uzurpuar dhe as të shfrytëzuar pronën e askujt, se paditësja prej vitit 1959 në kontinuitet të vazhdueshëm e shfrytëzon pronën dhe se për këtë ka një proces ligjor në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ndaj dhe i propozoi gjykatës që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë kishte konstatuar se paditësja e ka privatizuar këtë pronë të paluajtshme dhe e ka regjistruar atë në Zyrën Kadastrale të Komunës së O. në formë të qirambajtjes për 99 vjet, sipas Deklaratës së transferit dhe Marrëveshjes për shitjen e aksioneve të zakonshme në N. e R. Sh. nga AKP-ja, që vepron për dhe në emër të N. Sh. "B." në F. K.. Nga provat e administruara dhe faktet e vërtetuara gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses për lirim dhe pronës është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv.

Gjykata e Apelit e aprovoi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë procedurë kontestimore drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe se përfundimin e saj përkitazi me epilogun ligjor të çështjes e ka mbështetur në themelin faktik të formësuar drejtë dhe plotësisht mbi bazën e shkresave dhe provave të çështjes nga e cila rezulton themelësia e kërkesëpadisë së paditëses. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate duke vlerësuar ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar karshi pretendimeve ankimore të paditurit ka gjetur se të njëjtat nuk qëndrojnë dhe se nuk mbështetje në gjendjen e fakteve dhe provave që evidentohen në shkresat e çështjes. Pra, në këtë rast paditësja ka arritur të faktoj ekzistimin e të drejtave të tija mbi pronën objekt kontesti lirim dhe të cilës kërkohet. Për këto arsye Gjykata e Apelit e kishte refuzuar ankesën e të paditurit duke e aprovuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditëses pasi që këto dy aktgjykime të gjykatave të sipërpërmendura në këtë çështje kontestimore nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit sipas nenit 215 të LPK kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me shkeljet tjera thelbësore procedurale dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale në të cilat i padituri thirret në revizion.

Pretendimet e lartë përmendura të revizionit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave më të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt dhe në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse lidhur me mënyrën e vendosjes meritore të çështjes kontestuese. Në këtë kontekst, janë dhënë arsye bindëse me të cilat janë treguar faktet thelbësore të cilat janë marrë në vlerësim me rastin e vendosjes meritore, janë dhënë arsye për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e shfrytëzuara dhe për mënyrën e vlerësimit të provave të shfrytëzuara.

Në logjikën e njëjtë është edhe aktgjykimi i shkallës së dytë në të cilin paraqiten arsyet për konfirmimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm. Në këtë kontekst me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson të paqëndrueshëm pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimeve të instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme e Kosovës, refuzoi si të pabazuara pretendimet e revizionit gjyqtarja e cila ka vendosur në gjykatën e shkallës së parë, mund të jetë në konflikt interesi për faktin se ka punuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Kjo për faktin se përveç pohimit se ka punuar në Agjenci, me asnjë provë nuk u dëshmuua se vendimmarrja e gjyqtarës së shkallës së parë bie ndesh me dispozitat e nenit 67 të LPK-së, pasi që nuk ka asnjë provë që e njëjta ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose te organit tjetër, konkretisht Agjencisë e as që ekzistojnë rrethana

të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e saj sepse Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk është palë në këtë proces. Për këto arsye pretendimi tillë u refuzua si pa bazuar.

Pretendimi tjetër i revizionit se në procedurën e të provuarit, nga ana e paditëses nuk janë paraqitur provat origjinale të kalimit të pronësisë përmes procesit të shitjes u refuzua si i pa bazuar. Kjo për faktin se çështja e privatizimit ishte kryer në një proces të paraparë me ligj dhe nga organi kompetent dhe nuk është në kompetencë të kësaj gjykate që në këtë procedurë të vendos për ligjshmërinë e tyre. Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin e gjykatave të instancës më të ulët se në rastin konkret padia është paraqitur me kërkesën për lirimin e pronës së paluajtshme, ndërsa procesi i vërtetimit të pronësisë nuk është çështje e shqyrtimit për faktin se është zhvilluar një procedurë, në autoritetin e formuar me ligj dhe nga pronësia e ish N. Sh. ka kaluar tek paditësja N. e R. "T. B." Sh. sh.p.k. është shfrytëzues me kohë të caktuar si qirambajjtje për 99 vite e pronës së paluajtshme që është objekt i këtij kontesti. Të gjitha pretendimet rreth këtij procesi me të drejtë u refuzuar për faktin se edhe sipas pohimit të paditurit, lidhur me ligjshmërinë e këtij procesi është në procedurë e sipër padia e të paditurit për vërtetim pronësi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila ka juridiksion ekskluziv për të shqyrtuar çështjet që lidhen e privatizimin e pronës shoqërore sipas Ligjit NR. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit i cili në nenin 5 1.1.si kompetencë ekskluzive parasheh "kundërshtimi ndaj një vendimi apo ndonjë veprimi tjetër nga AKM-ja apo Agjencia, ndërmarrë në bazë të Rregullores së AKM-së, apo përkatësisht në bazë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit"

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon qëndrimin e gjykatave më të ulta se paditësja e ka fituar të drejtën e shfrytëzimit për 99 vjet e që është në pajtim me nenin 36 të Ligjit për mbrojtjen e pronësisë dhe të drejtave tjera pronësore të Kosovës, është paraparë mënyra e fitimit të pronësisë në paluajtshmëri, parashihet që: "Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri". Po ashtu në nenin 93 të Ligjit të njëjtë është paraparë mbrojtja e pronësisë, ku parashihet që: "pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi".

Pretendimi i të paditurit se aktgjykimi është i pa ligjshëm sepse është urdhëruar lirimi i pronave të cilat nuk janë në posedim të paditurit nuk u gjet me relevancë për faktin se kemi të bëjmë me lirim pronash të cilat paditësja i ka kërkuar ndërsa gjykata i ka aprovuar, dhe se lirimi i pronës nga i padituri nënkupton edhe zbatim të aktgjykimit të atakuar me revizion.

Për sa i përket pretendimeve të revizionit se pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës është parashtruar padi nga i padituri për vërtetim pronësie, gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë kanë konstatuar se me dispozitat e nenit 11 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit në lidhje me mjetet juridike në dispozicion të pjesëmarrësve në procedurë, parashihet "2. Dhoma e Posaçme do të vazhdojë të respektojë dhe zbatojë parimin e kompensimit në vend të kthimit fizik. Kur vendoset për mjetin juridik që do të jepet në një rast të caktuar, Dhoma e Posaçme do të marrë parasysh edhe dispozitat në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe legjislacionin pasues, duke përfshirë qëllimet publike që përcaktohen në preambulën e atij ligji. 3. Në rastet kur Dhoma e Posaçme vendos që njëra palë ka të drejtë, titull ose interes në apo mbi aksionin(et), apo interesa pronësie mbi një Ndërmarrje apo Korporatë, Pasuri në posedim të një Ndërmarrjeje apo Korporate, apo ndonjë pasuri tjetër mbi të cilën AKM-ja apo Agjencia ka ushtruar autoritetin e saj administrativ, si dhe aksioni(et), interesat pronësore apo Pasuria (apo të drejtat apo interesat mbi të) janë bartur tek një palë e tretë nga AKM-ja apo Agjencia në mirëbesim dhe në ushtrim apo veprim të arsyeshëm të autoritetit dhe përgjegjësive të veta administrative, sipas rregullores së AKM-së apo Ligjit mbi AKP-në: 3.1. një bartje e tillë, në bazë të ligjit, do të jetë gjithsesi e vlefshme dhe obligative, dhe asnjë aspekt i asaj bartjeje nuk do të preket nga një vendosje e tillë; si dhe 3.2. ajo palë do të ketë të drejtë vetëm në kompensim adekuat monetar për humbjen e të drejtës, titullit apo interesit të tillë. Lartësia e një kompensimi të tillë do të përcaktohet nga një vlerësues i licencuar i paluajtshmerisë në bazë të vlerës së tregut për transaksionin në fjalë të kryer nga AKM-ja apo Agjencia, ndërsa shkalla e përmbushjes së atij kompensimi është subjekt i dispozitave në fuqi të Ligjit për AKP-në.

Pas analizimit të këtyre dispozitave ligjore në raport me gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se në njërën anë, paditësja plotësisht ka të drejtë ligjore për të kërkuar lirimin e patundshmërisë të cilën e ka fituar ligjërisht nga një proces ligjor, pasi që paditësja të drejtën e pronësisë e ka fituar në bazë të Marrëveshjes për shitjen e Aksioneve të zakonshme nga ndërmjet: Agjencisë Kosovare të Privatizimit e cila vepron për dhe në emër të A.SH B. F. K. dhe A. I. shpk, me nr. biznesi K..... Paditësja të drejtën e pronësisë e ka dëshmuar me provat që i janë bashkangjitur padisë, si dhe të jetësuar edhe në Drejtorinë kadastrale përkatëse ku mbi bazën e kësaj paditësje është regjistruar si pronar i ngastrave, ndërsa në anën tjetër, i padituri ka obligim t'ia dorëzojë paditëses në posedim dhe shfrytëzim të lirë ngastrat lëndore, ndërsa nuk paragjykohet asnjë procedurë eventuale e kompensimit që është në zhvillim në Dhomën e Posaçme, kështu që për këto arsye nuk mund të qëndrojnë si të bazuara pretendimet e revizionit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadiisë së paditëses.

Gjykata Supreme vlerësoi edhe pretendimet tjera për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, të paraqitura në revizionin e të paditurit, por gjeti se ato pretendime janë të paqëndrueshme, ngase me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit asnjë dispozitë ligjore në të cilën thirret gjykata e shkallës së parë dhe e dytë, nuk është zbatuar gabimisht. Për më tepër me pretendimet e tilla të revizionit assesit nuk vihet në pyetje ligjshmëria e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë në aspektin material dhe procedural të tyre.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimet e cekura në revizion dhe gjeti se të njëjtat nuk i referohen konkretisht zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, për mënyrën e identifikimit të ngastrave dhe të ekspertizës, këto pretendime Gjykata e revizionit i refuzoi sepse kanë të bëjnë me gjendjen faktike, për të cilin shkak sipas dispozitës ligjore nga neni 214, par 2 të LPK–ës, revizioni nuk mund të paraqitet.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.554/2024, më 28.01.2025

Kryetari i kolegjit

Beshir Islami